



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr. 01-111/01-39676

Datë: 20.08.2026

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, duke u bazuar në nenin 42 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 08/L-294 dhe nenin 12 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) numër 07/2025 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, publikon këtë:

SHPLLJE PUBLIKE

për përzgjedhjen e profesorit të fushës si anëtar i Komisionit të Pranimi për pozitën për të cilën zhvillohet konkurrimi

Pagesa: 250 euro për çdo procedurë të rekrutimit në të cilën është angazhuar.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Profesori i fushës së njëjtë për pozitën për të cilën zhvillohet konkurrimi do të jetë anëtarë i Komisionit për Pranim dhe do të kryej detyrat e tij ashtu siç janë të përcaktuara në Rregulloren (QRK) numër 07/2025 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil.

Kriteret për aplikim:

- Për Grupin e Përgjithshëm të Inxhinierisë duhet të ketë diplomë të arsimit të lartë të nivelit të parë (Bachelor) në **Inxhinieri**, me përjashtim të Inxhinierisë Elektro-Teknologji **ndërsa** për Grupin e Inxhinierisë së Ndërtimit duhet të ketë diplomë të arsimit të lartë të nivelit të parë (Bachelor) në **Inxhinieri të Ndërtimit, Inxhinieri Strukturore, Inxhinieri Arkitekturore, Inxhinieri Gjeoteknike ose Hidroteknikë**.
- Të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale.
- Të mos jetë i dënuar për kryerjen e një veprë penale me dashje.
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi për shkelje të rëndë në institucionin publik.
- Të mos jetë i punësuar në shërbimin civil.

Dokumentacioni i kërkuar:

- Biografinë (CV-në).
- Kopjet e dokumentit personal (*letërnjoftim ose pasaportë*).
- Dëshmitë e kualifikimit profesional (diplomën bachelor). Për diplomat e pranuar jashtë vendit duhet të bashkëngjitet nostrifikimi i diplomës.
- Dëshmitë për përvojën e punës (vërtetim ose kontratë).
- Certifikatën e gjendjes penale të lëshuar nga institucionet kompetente të sistemit gjyqësor.
- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik

Të gjithë kandidatëve u garantohet trajtim i barabartë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Inkurajohen të aplikojnë të gjithë personat që i plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë shpallje.

Shpallja është e hapur nga data **21.08.2026** deri më **04.09.2026**. Aplikimet e dorëzuara pas afatit, si dhe aplikimet e pakompletuara ose ato që nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara në shpallje, nuk do të merren në shqyrtim.

Aplikimi dorëzohet fizikisht në *Sektorin për Administrimin e Dokumenteve* apo të dërgohen me postë në këtë adresë: *Komuna e Gjakovës, Rruga “UÇK” numër 53, 50000 Gjakovë, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Kati III.*